




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN 2023**

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Mangësi në përzgjedhjen e përfituesve për dy thirrjet publike për ndërtimin e shtëpive në vlerë të përbashkët 3,000,000€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë veprime të menjëhershme për shkak të ndikimit të tyre në PFV janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të pasurive si dhe bashkëpunimi me komunat për bartjen e pasurisë. Po ashtu, veprime duhet të ndërmiren edhe tek zbatimi i procedurave të duhura sa i përket thirrjeve për mbështetje me subvencione, si dhe tek menaxhimi i projekteve.

Ky raport ka rezultuar me tre (3) rekomandime, prej tyre një (1) është rekomandim i ri, një (1) pjesërisht i zbatuar dhe një (1) i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në përzgjedhjen e përfituesve sipas thirrjeve publike për ndërtimin e shtëpive

Gjetja

Sipas "Thirrjes publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna për të cilët ndihma është e nevojshme" dhe "Thirrjes publike për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në katër komunat veriore: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok", kriteret e vendosura përcaktojnë se prioritet në kushte të barabarta kanë kategoritë si në vijim: 1.Përfituesit potencialë ose familjar me nevoja të veçanta; 2.Përfituesit potencialë me familjar në gjendje të rëndë shëndetësore; 3.Përfitues potencial që nuk janë të punësuar dhe nuk janë përfitues të skemës sociale.4.Prindërit vetë ushqyese. 5.Numri i anëtarëve të familjes.

Lidhur me procedurat e përzgjedhjes së përfituesve për ndërtimin e shtëpive sipas dy thirrjeve publike për të cilat ishin ndarë mjete në vlerë të përbashkët 3,000,000€ për ndërtimin e shtëpive me sipërfaqe 75m2 dhe 62m2, është identifikuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme nga ana e komisionit për përzgjedhjen e përfituesve dhe ekzaminimin e tyre në terren para dhënies së subvencioneve.

Edhe pse ka qenë kërkesë e thirrjes që në kushte të barabarta prioritet duhet të kenë kategoritë e veçantë, nuk ka dëshmi se këto kriteret janë zbatuar nga komisioni përzgjedhës. Sipas listave të ofruara nga komisioni i vlerësimit, tek thirrja e parë e datës 07.08.2023, kishin aplikuar 200 pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë përderisa, sipas listës së komisionit, kriteret i kishin plotësuar 119 prej tyre dhe ishin përzgjedhur për t'u financiar vetëm 57 përfitues. Ndërsa, tek thirrja e dytë e datës 22.11.2023 kishin aplikuar 142 pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, sipas listës së komisionit, prej tyre 85 i kishin plotësuar kriteret për ndërtimin e shtëpive nga të cilët ishin përzgjedhur për t'u financuar vetëm 21 përfitues.

Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve nuk kishte përgatitur një raport detal për mënyrën e kategorizimit të përfituesve të cilët ishin priorizuar nga lista e plotë e përfituesve. Komisioni vlerësues kishte kryer vizita në terren për vlerësimin e gjendjes së përfituesve, por nuk kishte siguruar asnjë dëshmi për mënyrën e përzgjedhjes së 57, përkatësisht 21 përfituesve.

Më tej, ne kemi testuar edhe gjashtë (6) raste të aplikuesve të cilët sipas listave zyrtare edhe pse i kishin plotësuar kriteret për subvencionim nuk ishin përfitues. Për të njëjtit, nuk kishte dëshmi se si janë vlerësuar kriteret shtesë për rastet me kushte të barabarta sipas thirrjes publike.

Kjo kishte ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar aktivitetet e duhura të kontrollit lidhur me raportimin dhe monitorimin nga ana e komisionit për ndarjen e subvencioneve, me ç'rast nuk ishte dokumentuar sa duhet procesi i vlerësimit të aplikacioneve sipas kriterëve të përcaktuara nga ministria.

Ndikimi

Mungesa e dokumentimit të duhur lidhur me procesin e vlerësimit të përfituesve nuk jep siguri lidhur me zbatimin e kriterëve me prioritet në kushte të barabarta sipas thirrjes publike, si dhe rritë rrezikun e favorizimit

të aplikuesve gjatë përzgjedhjes së përfituesve.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurohet se nga zyrtarët përkatës po zbatohen kërkesat lidhur me vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga ministria. Procesi i vlerësimit të dokumentohet për të siguruar se janë zbatuar në plotësi kërkesat lidhur me plotësimin e kriterëve të thirrjes publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte në vlerë 5,381,350€, prej tyre ishin shpenzuar 3,612,973€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e ndodhura lidhur me bashkëfinancimet e komunave nga skema e grantit të performancës komunale, programit komunal për zhvillim të infrastrukturës etj.

Çështja B1 - Mangësi në realizimin e punimeve nga bashkëfinancimet me komuna

Gjetja

MAPL bazuar në Ligjin e Buxhetit 2023, kishte lidhur Marrëveshje Bashkëfinancimi për Programin për Mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete me komunitat e Republikës së Kosovës. Neni 7 i kësaj Marrëveshje përcakton që komunitat duhet të ndërmarrin të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit buxhetor 2023. Në anën tjetër, përgjegjësitë e secilës palë, duke përfshirë edhe përfundimin e punëve brenda vitit 2023, parashihen në kontratat publike në mes të komunave përkatëse me operatorët ekonomik, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara nga ana e MAPL me komunitat përkatëse.

Nga testimi i 18 mostrave për bashkëfinancime me komunitat përkatëse, vetëm pesë (5) projekte ishin përfunduar brenda afatit të paraprarë, ishin bërë pranimet teknike dhe MAPL kishte bërë kërkesa për fshirjen/ bartjen e pasurisë në komunitat përkatëse. Përderisa, për 12 projektet tjera, pagesat nga ana e MAPL-së ishin përfunduar, në anën tjetër komunitat përkatëse nuk i kishin kryer obligimet e tyre kontraktuale dhe financiare.

Ne kemi identifikuar dy (2) raste ku punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë:

- "Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën "Ismajl Luma"-Komuna e Lipjanit' - vlera e kontratës ishte 270,000€, vlera e zotuar nga MAPL ishte 235,374€ përderisa vlera e zotuar nga Komuna ishte 34,626€. Marrëveshja për mbështetje financiare të projektit nga skema e granteve për performancë komunale ishte nënshkruar me 2023, përderisa kontrata ishte nënshkruar me 06.07.2023 me afat për përfundimin e punëve për 120 ditë kalendarike, jo më vonë se 20.11.2023 ndërsa fatura lidhur me situacionin e dytë ishte pranuar me 13.10.2023 në vlerë prej 52,295€. Deri në prill të vitit 2024 përqindja e realizimit të projektit ishte vetëm 28.44%; dhe
- "Ndërtimi i dy nënkalimeve për këmbësor" - Komuna e Obiliqit- vlera e kontratës ishte 400,261€, vlera e zotuar nga MAPL ishte 250,000€ dhe përderisa vlera e zotuar nga Komuna ishte 150,261€. Marrëveshja ishte nënshkruar me 14.03.2023, përderisa kontrata ishte nënshkruar me 19.07.2023. Afati për kryerjen e punimeve në Kushte të veçanta të kontratës (KVK) ishte 120 dite kalendarike përderisa ishin kryer vetëm 82 % e punimeve. Bazuar në raportin e menaxherit të kontratës të datës 27.12.2023 ishin ndërprerë punimet për shkak të problemeve me infrastrukturë nëntokësore, kabllave dhe instalimeve të tensionit të lartë. Ne gjatë ekzaminimit fizik në prill të vitit 2024, kemi konstatuar që projekti ende nuk ishte përfunduar.

Kjo sipas MAPL dhe menaxherëve të kontratave kishte ndodhur për shkak

të vonesave pas nënshkrimit të Marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe kontratave si dhe vonesave në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga komunat. Poashtu, vonesat kishin ndodhur për shkak të problemeve të identifikuarara gjatë implementimit të projekteve.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MAPL të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktoj vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë që përmes stafit përkatës të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje, të ndër marrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar. Po ashtu, në bashkëpunim me komunat përkatëse duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese të kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësojë ndryshime prej planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 4,205,684€, pasurive jokapitale është 136,605€, si dhe e stoqeve 8,449€.

Çështja C1 - Mbivlerësim i pasurisë në PFV

Gjetja

Neni 13 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimit e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës.

Vlera e prezantuar e pasurisë në PFV ishte mbivlerësuar për 15,079€, në këtë ka ndikuar⁵ një (1) projekt i bashkëfinancuar me komuna në vlerë totale prej 15,079€ i cili edhe pse ishte përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik nga komisionet përkatëse, vazhdon të figuron në regjistrin e ministrisë si investime në vijim, duke e mbivlerësuar vlerën e pasurive kapitale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos koordinimit ndërmjet zyrtarëve të ministrisë dhe atyre të komunave përkatëse.

Ndikimi

Mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat përkatëse ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

Rekomandimi C1

Ministri përmes departamentit të monitorimit të komunave duhet të siguroj një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës të ministrisë dhe atyre të komunave, në mënyrë që të gjitha projektet e përfunduara përmes bashkëfinancimit për komuna të barten në regjistrat e tyre dhe njëkohësisht të azhurnohet regjistri i ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,691,668	12,949,198	7,851,011	5,060,469	3,871,569
Grante Qeveritare - Buxheti	9,691,668	10,922,753	7,343,957	4,188,076	3,576,725
Donacionet e jashtme	0	2,026,445	507,054	872,393	294,844

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 3,257,530€. Kjo rritje është rezultat i ndarjes së granteve të donatorëve si Fondet e Bashkimit Europian/Këshillit të Europës si dhe Bankës Botërore.

Në vitin 2023 MAPL kishte shpenzuar 7,851,011€ apo rreth 61% të buxhetit me një performancë jo të kënaqshme.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,691,668	12,949,198	7,851,011	5,060,469	3,871,569
Pagat dhe mëditjet	923,223	1,083,106	998,619	897,836	926,987
Mallrat dhe shërbimet	410,445	966,649	470,483	575,346	321,568
Komunalitë	8,000	8,724	4,388	5,374	5,005
Subvencionet dhe transferet	3,050,000	5,509,370	2,764,548	362,515	0
Investimet Kapitale	5,300,000	5,381,350	3,612,973	3,219,399	2,618,008

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 159,883€. Ky ndryshim ishte si rezultat i fondeve të alokuara nga Grantet e donatorëve si Instrumenti i para Anëtarësimit - IPA/ BNK, si dhe alokimit të grantit nga Banka Botërore. Buxheti ishte shpenzuar në nivel rreth 92%.


Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 556,204€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë si dhe alokimit të mjeteve nga grantet e donatorëve IPA/ BNK, si dhe grantit të donatorëve nga Banka Botërore. Realizimi i buxhetit ishte vetëm 49%.

Buxheti final për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 724€ nga Granti i donatorëve IPA/BNK. Buxheti final që përfshinë buxhetin e MAPL-së dhe Grantin e donatorëve IPA/BNK dhe Banka Botërore në total ishte 8,724€. Shpenzimet për këtë kategori janë 4,388€, apo 50%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 2,459,370€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë dhe projektit të Bankës Botërore. Realizimi i buxheti ishte 50%. Në këtë nivel kanë ndikuar vonesat në shpalljet të thirrjeve publike për subvencione.

Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 81,350€. Në këtë rritje kishte ndikuar nga bartja e mjeteve të donacionit të Bankës Botërore që i përkasin kategorisë së Pasurive Jo financiare. Realizimi i buxhetit ishte vetëm 67%. Ky nivel i realizimit ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit nga ana e komunave pas nënshkrimit të Memorandumeve të mirëkuptimit, vlerësimit të ofertave dhe nënshkrimit të kontratave me OE.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



MAPL nuk ka të hyra të rregullta. Përderisa pranimet e vitit 2023 kishin të bënin me kthimin e mjeteve nga Projekti i Bankës Botërore në vlerë prej 15,129€ për 5 projekte.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	15,129		
Të hyrat tjera	0	0	15,129		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të MAPL ka rezultuar në pesë (5) rekomandime. MAPL kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, MAPL kishte përgatitur edhe Raportin periodik për implementimin e rekomandimeve të dalura.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tre (3) rekomandime ishin zbatuar, një (1) rekomandim ishte zbatuar pjesërisht dhe një (1) nuk ishte zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri përmes departamentit të monitorimit të komunave duhet të siguroj një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës të ministrisë dhe atyre të komunave, në mënyrë që të gjitha projektet e përfunduara përmes bashkëfinancimit për komuna të barten në regjistrat e tyre dhe njëkohësisht të azhurnohet regjistri i ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet zhvlerësimi i të gjitha pasurive jo-kapitale me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.	Edhe gjatë vitit 2023 kishin raste të ngjajshme, megjithatë vlera e projekteve të identifikuara është më e ulët se në vitin paraprak.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që përmes stafit përkatës të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje, të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar. Po ashtu, në bashkëpunim me komunat përkatëse duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese të kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësojë ndryshime prej planit.	Edhe pse MAPL kishte ndërmarrë hapa dhe kishte kryer një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve kapitale, megjithatë nuk kishte arritur që të sigurojë bashkëpunim të plotë me komunat për monitorimin e projekteve kapitale të bashkëfinancuar a. Gjetja mbetet e pandryshuar.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dokumente mbështetëse, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në PVF.	MAPL kishte ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë që pozitat të cilat i ka të aprovuara me ligj të buxhetit plotësohen përmes procedurave të rekrutimit. Aplikimi i procedurave për MSHV të bëhet vetëm për mbulimin e pozitave specifike, përmes kriterëve të paracaktuara të matshme dhe konkrete.	Gjatë vitit aktual nuk kemi hasur në raste të reja.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkallimet e furnizimeve nga sasia e kontraktuar. Në rastet kur tejkallimi i kontratës arrin shkallën +30%, të mos bëhen porosi të reja.	Gjatë vitit aktual nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Valbona Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO			REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministartstvo Lokalne Samouprave / Administration Ministry of Local Government Administration			DATE/PRANIJA/DORËZUAR: DATUM/PRISHTINE/DORËZUAR: -6-06-2024			
Nr. Bc. No.	900-87/3	Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government		Nr. Prot. Bc. Prot. Prot. No.	Nr.faqeve Bc. Stranica No. Pages	
Datë Datum Date:	05.06.2024	Niveli Org. Org. Jedini. Org. Unit	Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code	03	47	
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave Ministry of Local Government Administration				776	1	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 30.05.2024

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Elbert Krasniqi

Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.